



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 982/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Dinamika” sh.p.k., me nr. unik identifikues 810971095, me seli në Prizren, fshati Poslishtë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat M.Q. nga Prizreni, kundër debitorit “The North Unicorn” L.L.C., me nr. unik identifikues 810112186, me seli në Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 448/22 të datës 28.07.2022, të lejuar nga Përbaruesi Privat Rushit Hoxha me seli të zyrës në Prizren, jashtë seancës, me datë 20.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “The North Unicorn” L.L.C., ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 448/22 i datës 28.07.2022, i lejuar nga Përbaruesi Privat Rushit Hoxha, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Dinamika” sh.p.k., me datë 28.07.2022 ka lëshuar Urdhrin përbarimor P.nr. 448/22 me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit: faturë nr. 02-D/2021 e dt.21.12.2021, faturë nr.01-D/2021 e dt. 03.12.2021, faturë nr.01-D/2021 e dt.14.02.2022, faturë nr. 02-D/2022 e dt. 22.03.2022, duke urdhëruar debitorin që t’i paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 7,886.01 EUR € (shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro e zero një euro cent), si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke theksuar se propozimin për përbarim e karakterizon parregullsia në përmbajtjen e tij për faktin se kreditori ka paraqitur si dokument të besueshëm fatura të cilat nuk i ka pranuar debitori, apo janë pranuar nga ndonjë person i pa autorizuar, me çka edhe është cenuar baza ligjore e këtij urdhri përbarimor. Debitori po ashtu

shton se faturat nuk janë të vulosura dhe të nënshkruar nga persona të autorizuar, dhe nuk i plotësojnë kushtet ligjore që dalin nga neni 29 par.3 i LPP-së dhe neni 20 (1.1.17) të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat. Tutje ka shtuar se debitori në lidhur me faturat e pranuar, ka bërë pagesë në vlerë prej 500.00 EUR, çka dëshmon seriozitetin dhe vullnetin e mirë të debitorit për t'i përmbushur obligimet ndaj kreditorit. Andaj ka kërkuar nga Gjykata që të aprovohet si i themeltë prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet Urdhri Përmbarimor P.nr. 448/22 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, pasi në të nuk janë paraqitur shkaqet dhe arsyet për paraqitjen e prapësimit konform nenit 69 dhe 71 të LPP-së, dhe se qëllimi i ushtrimit të prapësimit është vetëm shmangie e obligimit për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga dokumenti i besueshëm. Tutje ka shtuar se faturat të cilat janë objekt shqyrtimi janë të nënshkruara dhe të vulosura nga personat e autorizuar të debitorit dhe debitori nuk mund të thirret në atë se nuk ka qenë i njoftuar sepse në e-mailin e dt.21.07.2022, të skanuara i janë bashkangjitur edhe faturat që janë objekt i përmbarimit, të cilat debitori deri tani nuk i ka kundërshtuar, nuk i ka denoncuar, çka nënkupton se debitori ka qenë i njoftuar për këto fatura. Se debitori ka qenë i njoftuar këtë e dëshmon edhe fakti se i njëjti ka kryer pagesë të pjesshme të borxhit në shumën prej 500.00 EUR, të cilën nuk e konteston as kreditori. Andaj duke u bazuar nga të lartcekurat, ka kërkuar nga Gjykata që të refuzoj prapësimin e debitorit në tërësi ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*

monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se dokumentet: faturë nr. 02-D/2021 e dt.21.12.2021, faturë nr.01-D/2021 e dt. 03.12.2021, faturë nr.01-D/2021 dt.14.02.2022, dhe faturë nr.02-D/2022 e dt. 22.03.2022, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29.3 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e pasqyruar tek pranuesi i secilës faturë, dhe po ashtu këto fatura janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, andaj të njëjtat janë të përshtatshme për përmbarim dhe paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka bërë pagesë në vlerë prej 500,00 EUR andaj borxhi i kërkuar në propozimin për përmbarim nuk është real, por që nga dëftesa e pagesës e datës 01.03.2022, në përshkrimin e saj, nuk evidentohet se pagesa është bërë në emër të fatuave objekt i këtij përmbarimi. Në anën tjetër, në kartelën financiare të ofruar nga kreditori me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbarim, rezulton se pagesa prej 500.00 EUR është llogaritur për faturat paraprake të arritura për pagesë, e të cilat nuk janë pjesë e propozimit për përmbarim.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 982/23, datë 20.12.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE. Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.